



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 441 Prot.
7

Tiranë, më 13 .01.2022

VENDIM

Nr. 8 , datë 13 .01 .2022

PËR

**PROCEDURËN E KËRKESAVE TË STUDENTËVE SPORTISTË ELITARË
PËR NDJEKJEN E STUDIMEVE ME PLAN INDIVIDUAL**

Në zbatim të nenit 38, 84 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, në pikën 4 të VKM nr.305, datë 24.05.2006 “Për përcaktimin e kriterëve të nivelit të lartë sportiv dhe mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që arrijnë këto nivele”, në nenin 20, 79 (pika 7) të Statutit të UST-së, neni 7 dhe 106 të Rregullores së UST-së; Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 13.1.2022,

VENDOSI:

1. Të gjithë studentët, sportistë elitare, të cilët vijnë të përcaktuar si të tillë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, kanë të drejtë të ndjekin studimet me plan individual sipas programit ku janë të regjistruar.
2. Përshtatja e programit, ku ata ndjekin studimin me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore, bëhet nga dekanatet e njësive kryesore në bashkëpunim me njësinë bazë ku studenti ndjek studimet.
3. Rektorati miraton programin e përshtatur dhe ndjekjen e studimeve me plan individual.
4. Ky vendim i përcillet për zbatim Njësive Kryesore, zv/ Rektorëve, Sekretarisë Mësimore Digjitale, si dhe u bëhet me dije studentëve në faqen web të UST-së.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA

